



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mori në shqyrtim praktikën e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e Zyrtarit të Pajtushmërisë të OST sh.a. për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtushmërisë.
2. Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021 dhe vendosi si më poshtë vijon:
  1. OST sh.a., të vijojë procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në tregun e balancimit me formularët e pa ndryshuar sikurse është vepruar gjatë periudhës DRY Run. Rubrikat të cilat nuk mund të plotësohen, të lihen të pa plotësuara duke argumentuar arsyet përse nuk mund të plotësohet një rubrikë rast pas rasti.
  2. Mekanizmi i garancisë financiare që OST sh.a., do të aplikojë për pjesëmarrësit në tregun e balancimit të jete ai i përcaktuar në Rregullat e Mekanizimit të Përkohshëm të Balancimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017.
  3. Për periudhën deri në 30 Qershor 2021, Periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore.
  4. Shoqëria “OST” sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrik.